



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1049, datë 17.11.2009**

**Për**

**caktimin e dy kodeve të shkurtër sipërmarrësit “Interkom Albania” shpk në kategorinë e shërbimit “Thirrje me Kartë” (Calling Card).**

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 17.11.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, datë 02.05.2008, e ndryshuar me Vendimin nr. 746, datë 17.07.2009, bazuar në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Liçensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Interkom Albania” shpk për caktimin e dy kodeve të shkurtër në kategorinë e shërbimit “Thirrje me Kartë” (Calling Card).

**BAZA LIGJORE :**

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 – pika j) dhe nenet 80 deri 90;
- “Rregullorja për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit kombëtar të numeracionit” miratuar me VKD Nr. 932, datë 11.08.2009.
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I :**

1. Te miratojë kërkesën e sipërmarrësit “Interkom Albania” shpk dhe ti caktojë kodet e shkurtër si më poshtë:

**(0) 801 695** dhe

**(0) 801 697**

Ku:

- “0” - prefiksi kombëtar,
- “801” - identifikon Kodin e Aksesit te kategorisë se shërbimit “Thirrje me Kartë”  
i harmonizuar në nivel kombëtar,
- “695” - Numri identifikues i sipërmarrësit që ofron shërbimin,
- “697” - Numri identifikues i sipërmarrësit që ofron shërbimin.

2. Ngarkohen Drejtoria e Liçensimit për njoftimin e sipërmarrësit dhe Drejtoritë e tjera te AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES**

**Ilir SHEHU**

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**